



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, bazuar në përgjigjen e e DPUPK-së nr.V-943 e dt.17.08.2023, për kërkesën nr.II-19400/23 e dt. 25.07.2023, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr.- I-19399, të dt.25.07.2023, nga Bermas Therm SH.P.K. në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa me nr. I-19399 e dt.25.07.2023, e “Bermas Therm” SH.P.K. me përfaqësues z.Muhmet Berisha, ku përveq fabrikës për prodhimin e materialeve termoizoluese për nxemjet qëndrore nëntokësore, i mundësohet edhe operimi i biznesit të gastronomisë, në hapësirat e brendshme të objektit ku operon fabrika.
2. Plotësim ndryshimi i destinimit të operimit të kompanisë në fjalë, bëhet, bazuar në vendimin me nr.I-123 i dt. 30.09.2020, neni II pika 4 e vendimit si në vijim: “Në pronën e paluajftëshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të ” Bermas Therm” SH.P.K.” në zonën kadastrale në Llazarevë.
3. Ky zgjerim i destinimit nuk cënon në asnjë mënyrë obligimet kontraktuale, por do të mundësoj shtimin e veprimtarisë afariste, përmes së cilës do të gjenerohen vende të reja pune dhe të hyra komunale sipas Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
4. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL- dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
-MAPL
-Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi